

ZRRUM/UTSH-03/07/2009
31 Dhjetor 2008
Nr: 5/D

Në pajtim me autoritetin e dhënë me *Ligjin Nr. 03/L-086, Mbi Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjetës, Kanalizimit dhe Mbeturinae*, të datës 13 qershor 2008 me të cilën është amendamentuar *Rregullorja 2004/49* ("Ligji")

Duke u bazuar në të dhënat e aplikacionit për Tarifa Shërbimi të dorëzuara nga KUR "HIDROMORAVA" Sh. A., dhe në procesin e zhvilluar të analizave dhe të vlerësimit të tyre,

Konform Nenit 15 të *Rregullës për Përcaktimin e Tarifave të Shërbimeve të Ujësjetës, Kanalizimit dhe të Furnizimit të Ujit me Shumicë në Kosovë* të datës 12 gusht 2008 (Rregulla - ZRRUM R 02/U&K),

Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina ("ZRRUM") lëshon këtë:

URDHËRESË TË TARIFAVE TË SHËRBIMIT

PËR PËRCAKTIM TË TARIFAVE PËR SHËRBIMET E UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMIT QË DUHET TË APLIKOHEN NGA KUR "HIDROMORAVA" Sh. A. Gjilan

1. Interpretimi

Në këtë Urdhëresë të Tarifave të Shërbimit, përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe, fjalët dhe shprehjet me shkronja të mëdha do të kenë kuptimin që u atribuohen Rregullës ZRRUM- R 02/U&K.

2. Zbatueshmëria

Kjo Urdhëresë e Tarifave të Shërbimit është e zbatueshme dhe e detyrueshme për KUR "HIDROMORAVA" Sh. A. me rastin e faturimit të Shërbimeve të Ujësjetës dhe Kanalizimit që u ofron konsumatorëve të vet në tërë Zonën e Shërbimit.

3. Lista e Tarifave të Shërbimit

KUR "HIDROMORAVA" Sh. A. për konsumatorët e vet do të aplikojë Tarifat e Shërbimit ashtu siq janë dhënë në *Shtojcën 1* të kësaj Urdhërese të Tarifave të Shërbimit.

4. Afati

Tarifat e përcaktuara me këtë Urdhëresë të Tarifave të Shërbimit do të jenë të zbatueshme për periudhën **1 janar 2009 deri më 31 dhjetor 2011**.

ZRRUM mund ti bëjë korrigjimet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të tarifave në bazë të kërkesës së KUR "HIDROMORAVA" Sh.A. në pajtim me nenin 16 të Rregullës ZRRUM- R 02/U&K.

5. Publikimi dhe Shpërndarja e Listës së Tarifave të Shërbimit

- 5.1. KUR "HIDROMORAVA" Sh. A. duhet të shpërndajë Listën e Tarifave të Shërbimit të aprovuara me këtë Urdhëresë të Tarifave të Shërbimit, te secili Konsumator në momentin e nënshkrimit të Kontratës për Shërbime ose së paku një herë në vit bashkangjitur me Faturë.
- 5.2. Lista e Tarifave për Shërbime e aprovuar nga ZRRUM nën këtë Urdhëresë të Tarifave të Shërbimit duhet të publikohet nga KUR "HIDROMORAVA" Sh.A., së paku njërën prej gazetave ditore me tirazh gjithëpërfshirës në tërë Kosovën, brenda shtatë (7) Ditëve të Punës, pas shpalljes dhe publikimit nga ana e ZRRUM-it në ueb-faqen e vet.

6. Apelet

KUR "HIDROMORAVA" Sh. A. ka të drejtë të apelojë tek Komisioni për Shqyrtim që themelohet konform nenit 34. Komisioni shqyrtues, pika 34.1., Ligji Nr.03/L-086 *mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe Mbeturinave*, të datës 13 qershor 2008

7. Gjuha Zyrtare e Urdhrit të Tarifave për Shërbime

Kjo Urdhëresë për Tarifa të Shërbimit nxjerret dhe publikohet në tri (3) versione të shkruara të gjuhëve zyrtare që përdoren në Kosovë: (i) Shqip, (ii) Serbisht dhe, (iii) Anglisht.

Në rast të mospërputhjeve në mes të versioneve, do të mbizotërojë versioni i shkruar në gjuhën Shqipe.

.....
Afrim Lajçi
Drejtor i ZRRUM

SHTOJCA 1: LISTA E TARIFAVE TË SHËRBIMIT

1. Tarifa Fikse dhe Tarifa Volumetrike për Shërbimet e Ujësjellësit dhe Kanalizimit të Ujërave të Zeza

Afati i Aplikueshmërisë: 1 janar 2009 – 31 dhjetor 2011

Kategoria e Konsumatorëve	Tarifa Fikse (EURO/muaj)	Tarifa Volumetrike për Shërbime të Ujësjellësit (EURO/m³)	Tarifa Volumetrike për Shërbime të Kanalizimit (EURO/m³)
1.1. TARIFAT E APLIKUESHME PËR VITIN 2009 (1 JANAR 2009 – 31 DHJETOR 2009)			
Shtëpiak	1.0	0.28	0.07
Institucional dhe Industrial/Komercial	3.0	0.60	0.10
1.2. TARIFAT E APLIKUESHME PËR VITIN 2010 (1 JANAR 2010 – 31 DHJETOR 2010)			
Shtëpiak	1.0	0.29	0.07
Institucional dhe Industrial/Komercial	3.0	0.62	0.11
1.3. TARIFAT E APLIKUESHME PËR VITIN 2011 (1 JANAR 2011 – 31 DHJETOR 2011)			
Shtëpiak	1.0	0.30	0.07
Institucional dhe Industrial/Komercial	3.0	0.64	0.12

2. Taksat për Kyçje në Shërbime dhe Shpenzimet e Kyçjes në Shërbime

Afati i Aplikueshmërisë: 1 janar 2009 – 31 dhjetor 2011

2.1. Taksa për Kyçje në Shërbime*	Diametri i gypit të kyçjes/ujëmatësi	Shuma (EURO)
<p>Për të gjitha Kategoritë e Konsumatorëve</p> <p>(*) - Taksë e pakthyeshme e aplikueshme për kyçje të reja në shërbime në sistemin e ujësjellësit dhe të kanalizimit të ujërave të zeza.</p>	(13 – 25) mm	50.00
	32 mm	150.00
	40 mm	250.00
	50 mm	400.00
	65 mm	500.00
	80 mm	700.00
	100 mm	950.00
	150 mm	1400.00
2.2. Shpenzimet e Kyçjes në Shërbime të Ujësjellësit*	Diametri i gypit të kyçjes/ujëmatësit	Shuma (EURO)
<p>Për të gjitha Kategoritë e Konsumatorëve</p> <p>(*) - Shpenzimet e Kyçjes në Shërbime përfshijnë shpenzimet e punës dhe materialit në vijim: qafore, pajisjet për kyçje, gypat e kyçjes në gjatësi deri 15 metra, ujëmatësi dhe dy valvula. Punët tokësore dhe ato të betonit nuk janë të përfshira.</p>	(13 – 20) mm	120.00
	(25 – 32) mm	160.00
	(40 – 50) mm	220.00
	> 50mm	Do të llogaritet në bazë të çmimeve për material dhe punën.
2.3. Shpenzimet e Kyçjes në Shërbimet e Kanalizimit *	Diametri i gypit të kyçjes/ujëmatësit	Shuma (EURO)
<p>Për të gjitha Kategoritë e Konsumatorëve</p> <p>(*) – Shpenzimet e Kyçjes në Shërbime përfshijnë shpenzimin e punës dhe të materialit në vijim: elementet fazonike për kyçje dhe gyp në gjatësi deri 15 metra.</p>	DN 110 mm	100.00
	DN 160 mm	120.00
	DN 200 mm	160.00
	> 200 mm	Do të llogaritet në bazë të çmimeve për material dhe punën.

3. Tarifat për Shërbimet Tjera

Afati i Aplikueshmërisë: 1 janar 2009 – 31 dhjetor 2011

Lloji i Shërbimit	Shuma (EURO)
3.1. Dërgimi i Njoftimit për Shkyçje	10.00
3.2. Shkyçja e Shërbimeve të Ujësjellësit	25.00
3.3. Rikyçja e Shërbimeve të Ujësjellësit	25.00
3.4. Riparimi i rrjedhjeve në objektin e Konsumatorit	Duhet të llogaritet në bazë të çmimeve për material dhe punën.
3.5. Gjoha për kyçje ilegale	100.00
3.6. Gjoha për moskryerje të riparimit të rrjedhjes në objektin e konsumatorit	100.00
3.7. Shitja e ujit me cisterna të ujit – transporti deri në 5 km	20.00 EURO/5m3
3.8. Riparimi i ujëmatësit	Max. 80% të çmimit të ujëmatësit
3.9. Kontrollimi i ujëmatësit – verifikimi i saktësisë	30.00